



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 97/2 prot.

Tiranë, më 20.12.2024

**V E N D I M**  
**Nr.83, datë 20.12.2024**

**PËR**  
**MIRATIMIN E RAPORTIT MBI SKEMËN E ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT**  
**CIVIL NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS VENDORE**

- Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,
- Bazuar në Vendimin nr. 9, datë 30.01.2024, të Komisionerit, “Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2024 dhe ngritjen e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces”; Udhëzuesin nr. 654 prot., datë 02.10.2024, të Komisionerit, “Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civil për shkak të ristrukturimit të institucionit”,

në përfundim të procesit të administrimit/analizimit të të dhënave të grumbulluara të materializuara në Raportin e Vlerësimit,

**V E N D O S A:**

1. Miratimin e Raportit të Vlerësimit “Mbi skemën e administrimit të shërbimit civil në institucionet e administratës vendore”.

2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, [www.kmshc.al](http://www.kmshc.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**